



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa:Rr."Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,
Tel/fax:++381(0)38 229 838, e-mail:bspk@etuc.org



Punëtorë e FAN-it në grevë

Prishtinë 20 prill 2011 -Punëtorët e Fabrikës “FAN” të Podujevës që tri ditë janë në grevë para fabrikës duke kërkuar informata për paga dhe rritjen e pagave konform inflacionit dhe kushteve për jetesë. Dështimi i privatizimit me spin-off special, kësaj here e kishte prodhuesi i armaturës “FAN” në Podujevë, që nuk arriti t’i përmbushë obligimet e saj për investime dhe punësim.

Si pasojë, afër 100 punëtorë të kësaj fabrike kanë hyrë në grevë, për shkak se menaxhmenti i fabrikës shkeli marrëveshjen.

Këtë fakt e ka të qartë edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, e cila pranon se blerësi ka dështuar, por që nuk tregon se kur do ta marrë një vendim.

Ata që po i vuajnë pasojat janë vetë punëtorët.

Sipas drejtuesve të sindikatës se FAN’it hyrja në grevë është bërë për çështjen e pagave të ulëta dhe shkelja e marrëveshjes nga menaxhmenti. Mesatarja e pagës që kanë marrë kohëve të fundit punëtorët ka qenë vetëm 138 euro.

Në bisedat që kanë pasur me menaxhmentin, thonë se arsyetimi i tyre ka qenë se nuk kanë momentalisht më shumë mjete.

Para privatizimit të fabrikës, punëtorët kanë punuar gjatë tërë muajit, ndërkohë që tani kjo nuk është duke ndodhur. Ka nga ta që punojnë vetëm tri javë. Kjo po bëhet me qëllim

nga menaxhmenti, në mënyrë që punëtorët t'i paguajë më pak. Blerësi me kontratë është dashur t'i punësojë në fabrikë 236 persona, por që nuk ka ndodhur as kjo. Fabrika numëron gjithsej 95 punëtorë.

Në mbështetje grevistëve u ka dalë edhe Sindikata e Pavarur e Metalistëve të Kosovës. Përmes një komunikate, kjo sindikatë ka sqaruar se, pavarësisht dialogut në mes të menaxhmentit dhe sindikalistëve, nuk ka pasur ndonjë rezultat pozitiv. Për më tepër, numri i punëtorëve është duke u rritur dhe me punëtorët grevistë janë duke u solidarizuar edhe qytetarët e Podujevës.

**Zyra për Informim, BSPK
Fatma Rastelica**